



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIA ARCHIVA-ARCHIVE OFFICE

Org. Jedin. 01 Nr. Prot. 139
Org. Upr. Prot. No:
Nr. 139
Brosj stranica 01 Data 22.12.2011
No. pages: 01 Datum:

PRISHTINË/A



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 04/11
Datë: 22.12.2011

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 2, 4 dhe 5 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësit e Agjencisë morën:

V E N D I M

1. Urdhërohet operatori i telefonisë mobile Z-mobile që pas verifikimit të nevojshëm të të dhënave të deklaruara gjatë regjistrimit të mos ndalin/mbajnë fotokopje të asnjë dokumenti në të cilin ka të dhëna personale.
2. Afati për ndalimin e depozitimit fillon nga data 01. 01. 2012.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Gjatë inspektimit të operatorit të telefonisë mobile Z-mobile e kemi vërtetuar se operatori në fjalë depoziton fotokopje të dokumenteve personale të abonentëve, depozitimi i të cilave është në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 2, 4 dhe 5 të Ligjit 03/L-172. Operatori mund të kërkojë dokumentet e nevojshme për verifikim për të arritur qëllimin e saj, por pas verifikimit çdo depozitim i fotokopjeve të dokumenteve të cilat mbajnë të dhëna personale është kundërligjore, ngase depozitimi i këtyre të dhënave tejkalon qëllimin për të cilin përpunohen.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrës Shtetëror
Državni Nadzornik

Mentor Hoxhaj

Bekim Demiri

Aleksandar Spasic

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Operatorit të telefonisë mobile Z-mobile
- Arkivit të Agjencisë

